



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Rregulla ZRRE/Nr. 02/2022**

# **RREGULLA PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLËS NR. 07/2017 PËR LICENCIMIN E AKTIVITETEVE TË ENERGISË NË KOSOVË**

**Prishtinë, 29 Korrik 2022**



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë me Nenin 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenin 26 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe Nenin 38 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084 dhe Nenin 24 paragrafi 1 të Rregullës Nr. 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, në seancën e mbajtur me datë 29 korrik 2022 miratoi:

## **RREGULLËN PËR NDYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLËS NR. 07/2017 PËR LICENCIMIN E AKTIVITETEVE TË ENERGJISË NË KOSOVË**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregulle është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullës Nr. 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë të datës 31.03.2017.

### **Neni 2**

Neni 3 paragrafi 4 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

“Për aq sa e lejon legjislacioni në fuqi i Republikës së Kosovës nuk do të kërkohet aplikimi për licencim për Furnizim me shumicë (tregtim) me energji elektrike dhe Furnizim me energji elektrike, në rast se një ndërmarrje ka një licencë të lëshuar nga një autoriteti Rregullator i një vendi tjetër Palë Kontraktore e Komunitetit të Energjisë/një shteti Anëtar i Bashkimit Europian, ose një vendi tjetër me të cilin është nënshkruar një marrëveshje dypalëshe për njohjen reciproke të licencave ndërmjet Rregullatorit dhe autoritetit përkatës Rregullator, si dhe me kusht që të dorëzojnë në Rregullator dëshmitë si në vijim:

- a) Aplikacionin për Njohje të Licencës për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike apo Licencës për furnizim me energji elektrike (të cilat do të nxirren dhe publikohen nga Rregullatori);**
- b) Licencën e lëshuar nga shteti amë, të përkthyer dhe noterizuar;**
- c) Certifikaten e regjistrimit të Degës në Kosovë; si dhe**
- d) Konfirmimin nga Rregullatori/institucioni i shtetit amë për njohje reciproke të licencave të lëshuara në Kosovë. ”**



### **Neni 3**

Në nenin 3 shtohet paragrafi i ri (5) me tekstin si në vijim:

“Në rast se Rregullatori vendos të njohë Licencën për furnizim me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike apo Licencën për furnizim me energji elektrike, ndërmarrja që do të ushtrojë këto veprimtari do të konsiderohet si e licencuar dhe do ti nënshtrohet rregullave të aplikueshme të tregut, rregullave fiskale dhe rregullave të balancimit si dhe të gjitha detyrimeve dhe të drejtave të të licencuarve nga Rregullatori, që përcaktohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.”

### **Neni 4**

Në nenin 3 Shtohet paragrafi i ri (6) me tekstin si në vijim:

“Brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve kalendarike nga parashtrimi i aplikacionit të kompletuar, Rregullatori do të vendosë lidhur me aplikacionin për njohje të licencës. Në rast se kërkesa për njohje refuzohet, aplikuesi nuk mund të parashtrij kërkesë të re para gjashtëdhjetë (60) ditëve kalendarike nga data e refuzimit të aplikacionit.”

### **Neni 5**

Në nenin 3 Shtohet paragrafi i ri (7) me tekstin si në vijim:

“Rregullatori do mbaj dhe publikojë në faqen zyrtare elektronike të saj Regjistrin për njohje reciproke të licencave.”

### **Neni 6**

Në nenin 3 Shtohet paragrafi i ri (8) me tekstin si në vijim:

“Taksa Vjetore e licencimit do të paguhet në pajtim me Rregullën për Taksat numër ZRRE/Nr.01/2020 (Shtojca 1, pika B1).”

### **Neni 7**

Në nenin 3 Shtohet paragrafi i ri (9) me tekstin si në vijim:

“Rregullatori do të monitorojë këto aktivitete në pajtim me legjislacionin në fuqi.”

### **Neni 8**

Neni 5 paragrafi 6 fshihet në tërësi.



#### Neni 9

Dispozitat tjera të Rregullës Nr. 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë të nxjerr me datë 31.03.2017 të aprovuar nga Bordi i ZRRE-së, do të mbeten të pandryshuara dhe do të zbatohen në tërësi.

#### Neni 10

##### Hyrja në fuqi

Kjo Rregull për Plotësim Ndysim të Rregullës Nr. 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, hyn në fuqi në datën e aprovimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të ZRRE.

**Bordi i Rregullatorit:**

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Izet Rushiti, Anëtar

Selman Hoti, Anëtar

Lutfie Dervishi, Anëtar

Ganj Buçaj, Anëtar